



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më 06.05.2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Blerje produkte ushqimore, fruta-perime, mish viçi, produkte bulmeti dhe buke per QEA” i ndare ne lote

LLOJI PROÇEDURËS - “Proçedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – mallra”- Marreveshje Kuader

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 15111200-1 - Mish viçi, 15330000-0 - Fruta dhe perime të përpunuara, 15542000-9 - Djathë i freskët, 15542100-0 - Gjizë, 15800000-6 - Produkte ushqimore të ndryshme, 15811100-7 - Bukë

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 53’578’870 (pesëdhjetë e tremilion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa t.v.sh. e ndare si e me poshte:

Loti I: “Blerje Produkte Ushqimore per QEA” me fond limit prej 23’435,380 (njëzet e tremilion e katerqind e tridhjetë e pesemije e treqind e tetëdhjetë) leke pa t.v.sh.

Loti II: “ Blerje Fruta-Perime per QEA” me fond limit prej 11,810,840 (njembedhjetemilion e teteqind e dhjetemije e teteqind e dyzet) leke pa t.v.sh.

Loti III : “Blerje Mish Viçi per QEA” me fond limit prej 5,145,900 (pesëmilion e njeqind e dyzet e pesemije e nenteqind) leke pa t.v.sh.

Loti IV : “Blerje Produkte Bulmeti per QEA” me fond limit prej 7,954,750 (shtatemilion e nenteqind e pesedhjetë e katermije e shtateqind e pesedhjetë) leke pa t.v.sh.

Loti V : “Blerje Buke per QEA” me fond limit prej 5,232,000 (pesëmilion e dyqind e tridhjetë e dymije) leke pa t.v.sh.

I mbajtur sot me date **06.05.2025**, ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, I ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Loti I

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit** të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiar **2022, 2023, 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kriteri 2.2.2 është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”si dhe Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet te kete paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 2.2.3 eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP sidhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvijes se meparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvija e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvijën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën kategoria II.1.A.1 - "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKB dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa" e ndryshuar, per licencat e grupit te trete (qe i perkasin AKU-se);

2.3.3. Në rastet kur, operatorët ekonomikë nuk kane detyrim ligjor të liçensohen nga QKB, duhet të paraqesin ekstraktin tregëtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti që prokurohet.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton përfshirjen e objektit tone te prokurimit tek ekstrakti tregëtar, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKB dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa" e ndryshuar, per licencat e grupit te trete (qe i perkasin AKU-se) si dhe Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore".

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambjent të përshtatshëm me sipërfaqe minimumi 50 m² për prodhimin ose magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë **aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira të objektit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambjenti duhet të plotësojë kushtet higjieno sanitare dhe teniko teknologjike, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambjentit. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambjentit.**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore" pasi gjykohet e nevojshme nga AK për të siguruar në cilësinë e mallit që ofron operatori ekonomik si dhe për një furnizim në vijimësi e të vazhdueshëm.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë një **automjet të përshtatshëm ATP** (minimumi i kapacitetit mbajtës është 500 kg) për transport mallrash ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit. Në rastin e marrjes me qira kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Automjeti duhet të plotësojë kushtet higjieno sanitare, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponueshmerinë e automjetit,

do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Eshte vendosur ky kriter pasi eshte ne perputhje me objekin e prokurimit dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore" pasi gjykohet e nevojshme per realizimin me sukses te kontrates duke u nisur nga lloji i artikujve qe do te transportohen.

2.3.6 - Një punësim mesatar i të paktën 3 (tre) personave të siguruar për tre muajt e fundit, për të cilët ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Kontratë pune, librezë shëndetsore dhe për njërin nga punonjësit duhet të paraqesë edhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponueshmerine e stafit te nevojshem, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri 2.3.6 eshte vendosur ne baze te pikes 4, te nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe kane ne dispocion apo qe mund ti vihen.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- **ISO 22000:2018** mbi “Certifikate e sistemit te menaxhimit te sigurise ushqimore” ose ekuivalente me to .

Kriteri 2.3.2 është vendosur në përputhje me Nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 79 të LPP. Është vendosur ky kriter pasi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe bazuar në Rekomandimin e perbashket datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore" si dhe AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatën e menaxhimit të sigurisë ushqimore .

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Kriteri 2.3.8 është vendosur pasi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe bazuar në Rekomandimin e perbashket datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore".

Operatorët ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues ,ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe bazuar në Rekomandimin e perbashket datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore".

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.4 2.3.5 dhe 2.3.6 të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në parashikimet e nenit 77, pika 3, të LPP-së dhe nenit 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet që nëse një operator ekonomik oferton për më shumë se një lot duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Loti II

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit** të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit

Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiar **2022, 2023, 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kriteri 2.2.2 është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri **2.2.3** është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP-së dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvijes së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruarat në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- c) **Në rast se përvija e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruarat në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën kategori II.1.A.1 - "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 5, germa a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në VKM-në Nr.538, datë 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet QKB dhe disa rregullave të tjera nenligjore të perbashketa" e ndryshuar, për licencat e grupit të trete (që i perkasin AKU-se);

2.3.3. Në rastet kur, operatorët ekonomikë nuk kanë detyrim ligjor të liçensohen nga QKB, duhet të paraqesin ekstraktin tregëtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti që prokurohet.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton perfshirjen e objektit të prokurimit tek ekstrakti tregetar, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKB dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa" e ndryshuar, per licencat e grupit te trete (qe i perkasin AKU-se) si dhe Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterave te vecanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore".

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambjent të përshtatshëm me sipërfaqe minimumi 50 m² për prodhimin ose magazinimin e mallrave që janë objekt i këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë **aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira të objektit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambjenti duhet të plotësojë kushtet higjieno sanitare dhe tekniko teknologjike, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë për disponimin dhe adresën e saktë të ambjentit. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambjentit.**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterave te vecanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore" pasi gjykohet e nevojshme nga AK per tu siguruar ne cilesine e mallit qe ofron operatori ekonomik si dhe per një furnizim në vijimësi e të vazhdueshëm.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **një automjet të përshtatshëm ATP** (minimumi i kapacitetit mbajtës është 500 kg) për transport mallrash ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit. Në rastin e marrjes me qira kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Automjeti duhet të plotësojë kushtet

higjeno sanitare, vërtetuar kjo nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponueshmerine e automjetit, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Eshte vendosur ky kriter pasi eshte ne perputhje me objekin e prokurimit dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore" pasi gjykohet e nevojshme per realizimin me sukses te kontrates duke u nisur nga lloji i artikujve qe do te transportohen.

2.3.6 - Një punësim mesatar i të paktën 3 (tre) personave të siguruar për tre muajt e fundit, për të cilët ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Kontratë pune, librezë shëndetsore dhe për njërin nga punonjësit duhet të paraqesë edhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponueshmerine e stafit të nevojshëm, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 2.3.6 është vendosur në baze të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqesë:

- **ISO 22000:2018** mbi “Certifikate e sistemit te menaxhimit te sigurise ushqimore” ose ekuivalente me to .

Kriteri **2.3.7** eshte vendosur ne perputhje me Nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP. Eshte vendosur ky kriter pasi eshte ne perputhje me objekin e prokurimit dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore" si dhe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te sigurise ushqimore .

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Kriteri **2.3.8** eshte vendosur pasi eshte ne perputhje me objekin e prokurimit dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore".

Operatoret ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacion provues ,ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe bazuar ne Rekomandimin e perbashket date 19.11.2018 te Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore".

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.4 2.3.5 dhe 2.3.6 të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa

shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në parashikimet e nenit 77, pika 3, të LPP-së dhe nenit 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet që nëse një operator ekonomik oferton për më shumë se një lot duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Loti III

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të prokuruar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 2.2.2 është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- d) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit

ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçencën kategoria II.1.A.1 - "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz" lëshuar nga QKB ose liçencën kategoria II.1.B - "Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)" lëshuar nga QKB.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKB dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa" e ndryshuar, per licencat e grupit te trete (qe i perkasin AKU-se);

2.3.3. Në rastet kur, operatorët ekonomikë nuk kane detyrim ligjor të liçensohen nga QKB, duhet të paraqesin ekstraktin tregëtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë dhe objekti që prokurohet.

